



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1823/7 Prot.

Tiranë, më 27/06/2024

VENDIM

Nr. 97, datë 27.06.2024

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË PËRHERSHËM
DHE PROMOVIMIN E PERSONELIT AKADEMIK
NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenet 3, 38, 46 dhe 61; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademik “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar; Statutit të UMT-së, nenet 5, 26 dhe 75, si dhe Relacionin nr. 1792 prot., datë 24.06.2024, Senati Akademik, pasi shqyrtoi dhe diskutoi këtë Relacion dhe projekt rregulloren bashkëlidhur, në mbledhjen e datës 27.06.2024,

VENDOSI:


1. Miratimin e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përhershëm dhe Promovimin e Personelit Akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, bashkëlidhur këtij Vendimi.
2. Vendimet e Senatit Akademik të UMT-së nr. 33, datë 17.03.2020 për “Miratimin e Rregullores për fitimin e titujve akademikë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, i ndryshuar dhe nr. 35, datë 17.03.2020 për “Miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e KPPPA të UMT-së”, shfuqizohen.
3. Vendimi i përcillet për njohje dhe zbatim KPPPA dhe njërive kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.

KRYETARI
Prof. Dr. Arben GJATA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

SENATI AKADEMIK

RREGULLORE

**“PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E KOMISIONIT TË PËRHERSHËM
DHE PROMOVIMIN E PERSONELIT AKADEMIK
NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr. 97, datë 27.06.2024

Tiranë 2024

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

Kjo Rregullore ka për objekt përcaktimin e rregullave dhe procedurave që duhet të zbatohen nga subjektet pjesëmarrëse në procesin për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik dhe strukturave përgjegjëse, si dhe raportet me organet dhe autoritetet përgjegjëse për promovimin e personelit akademik.

Neni 2 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të sigurojë që, procesi i promovimit të personelit akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për fitimin e titujve akademikë; me standardet shtetërore për fitimin e titujve akademikë, si dhe me etikën në kërkimin shkencor.

Neni 3 Baza ligjore

Kjo rregullore mbështetet në ligjin nr. 80/2015 *"Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*; Kodin e Procedurave Administrative në RSH; ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 *"Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"*; VKM nr. 112, datë 23.02.2018, *"Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", i ndryshuar; VKM nr. 777, datë 26.12.2018, "Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore"*, i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 29, datë 18.12.2019 *"Për krijimin dhe administrimin e regjistrave shtetërorë të gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar në Republikën e Shqipërisë"*; Statutin dhe Kodin e Etikës të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Neni 4 Fusha e veprimit

Pas hyrjes në fuqi, kjo Rregullore zbatohet nga Komisioni i Përherëshëm për Promovimin e Personelit Akademik (këtu e më poshtë Komisioni), strukturat e tjera përgjegjëse, si dhe çdo subjekt tjetër, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për promovimin e personelit akademik.

KREU II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR PROMOVIMIN E PERSONELIT AKADEMIK

Neni 5

Përbërja e Komisionit

1. Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, është organi kolegjal përgjegjës për dhënien e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor” në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
2. Komisioni përbëhet nga 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë, të cilët mbajnë titullin “Profesor” dhe janë personel akademik me kohë të plotë në njësitë kryesore të UMT-së. Ata vetëkandidohen dhe përzgjidhen nga Senati Akademik i UMT-së.
3. Mandati i anëtarit të Komisionit është 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Mandati mbaron para kohe në rastet e mëposhtme:
 - a) me mbarimin e afatit;
 - b) me dorëheqje;
 - c) kur ndërpret marrëdhëniet e punës me UMT-në;
 - d) kur mungon pa arsye në 6 (gjashtë) seanca radhazi mbledhjesh të tij;
 - e) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - f) në rastet e pamundësisë për të kryer detyrën;
 - g) në rastet e shkeljeve të rënda të ligjit;
 - h) kur humb jetën.
4. Vendi bosh i anëtarit të Komisionit plotësohet me kandidatin e radhës, të përzgjedhur nga Senati Akademik, ose kryhet një proces i ri kandidimi dhe përzgjedhjeje, kur në listën e votuar nga Senati Akademik nuk ka më kandidatë.
5. Anëtari i Komisionit nuk duhet bëjë pjesë në ndonjë komision tjetër të përhershëm të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Neni 6

Kompetencat e Komisionit

1. Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik ka këto kompetenca:
 - a) organizon dhe drejton kualifikimin shkencor pedagogjik pas doktoratës, në përputhje me standardet shtetërore për fitimin e titujve akademikë;
 - b) miraton formatin standard për procedurat e vlerësimit të kandidatëve, si më poshtë:
 - i. Skeda e kandidatit për titujt akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”;
 - ii. Skeda e Departamentit për titujt akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”;
 - iii. Skeda dhe Relacioni i Relatorit për titujt akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”;
 - iv. Skeda dhe Raporti i Jurisë së Vlerësimit për titujt akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”;
 - c) ngre jurinë e vlerësimit për aplikim për fitimin e një titulli akademik, cakton kryetarin e saj dhe mbikëqyr funksionimin e jurisë;

- d) merr vendimin përfundimtar për dhënien e titujve akademikë;
 - e) merr vendim për shfuqizimin e titujve akademikë, sipas përcaktimeve në nenin 27 të kësaj Rregulloreje;
2. Gjatë kryerjes së veprimtarisë funksionale, Komisioni bashkëpunon me njësitë përgjegjëse në procesin e promovimit të personelit akademik.

Neni 7 Kryetari i Komisionit

1. Në mbledhjen e parë, Komisioni zgjedh Kryetarin e tij, me votim të fshehtë, me shumicën e thjeshtë të votave të të gjithë anëtarëve të tij, (50% + 1).
2. Mandati i Kryetarit është 2 (dy) vjeçar.
3. Kandidati për Kryetar vetëkandidohet ose propozohet nga një ose më shumë anëtarë të Komisionit.
4. Kryetari i Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik kryen këto detyra:
 - a) Drejton mbledhjet e Komisionit;
 - b) Organizon punën e Komisionit për ndjekjen dhe monitorimin në vazhdimësi, të procesit të dhënies së titujve akademikë;
 - c) Organizon punën për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave në lidhje me procesin e dhënies së titujve akademikë;
 - d) Përfaqëson Komisionin në marrëdhënie me të tretët;
 - e) Informon, në mënyrë periodike, drejtuesit e njësisve kryesore dhe Rektoren apo zv. Rektoren për Kërkimin Shkencor në UMT, për problematikat që janë konstatuar;
 - f) Përcjell vendimet e KPPPA, në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe atyre institucionale;
 - g) I gjithë komunikimi shkresor zhvillohet përmes zyrave të protokollit të UMT-së dhe njësisve kryesore përbërëse të saj.
5. Komisioni ka një zëvendëskryetar, i cili caktohet nga kryetari i Komisionit ndërmjet anëtarëve të Komisionit, me funksion zëvendësimit të kryetarit, në rast mungese të tij ose në rast delegimi të drejtimit të Komisionit.

Neni 8 Të drejtat dhe detyrat e anëtarit të Komisionit

1. Anëtari i Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik ka këto të drejta:
 - a) të marrë informacionin e nevojshëm dhe të duhur për çështje të Komisionit;
 - b) të propozojë mbajtjen e mbledhjes dhe të çështjeve për rendin e ditës;
 - c) të jetë relator i Komisionit;
 - d) të shprehë mendimin “kundër”, për vendimet e komisionit kur e vlerëson.
2. Anëtari i Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik ka këto detyra:
 - a) të marrë pjesë rregullisht në të gjitha mbledhjet e komisionit, me përjashtim të rasteve kur ka arsye objektive dhe njofton paraprakisht kryetarin;
 - b) të mbajë qëndrim proaktiv për çështjet që janë objekt i veprimtarisë së Komisionit;

- c) të respektojë legjislacionin në fuqi, standardet shtetërore për dhënien e titujve akademikë dhe standardet etike;
- d) të angazhohet si relator i Komisionit për aplikime të caktuara;
- e) të respektojë afatet kohore për realizimin e detyrave dhe procedurave sipas parashikimeve ligjore dhe administrative;
- f) të vetëdeklarojë dhe shprehet për rastin e konfliktit të interesit;
- g) të ruajë konfidencialitetin për çështjet e trajtuara;
- h) të zhvilluara në mbledhjet e Komisionit.

Neni 9 Thirrja e mbledhjeve

1. Si rregull, mbledhjet e Komisionit thirren nga Kryetari i tij.
2. Thirrja e mbledhjeve mund të bëhet edhe me kërkesë të 1/3 e anëtarëve të KPPPA-së, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje.
3. Lajmërimet për thirrjen e mbledhjeve, si rregull bëhen brenda 10 (dhjetë) ditëve pas paraqitjes së kërkesës nga 1/3 e anëtarëve, por jo më vonë se 48 orë para datës së mbajtjes së mbledhjes.
4. Thirrja e mbledhjeve, bëhet me shkrim dhe/ose nëpërmjet postës elektronike (e-mail). Njoftimi për mbledhje duhet të përmbajë rendin e ditës sipas çështjeve të cilat do të diskutohen, si dhe materialet që do të diskutohen në mbledhje, referuar rendit të ditës.

Neni 10 Zhvillimi i mbledhjeve

1. Mbledhja e Komisionit është e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se 2/3 e anëtarëve të tij (njëmbëdhjetë anëtarë), përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga kjo Rregullore.
2. Kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë, Kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër, të paktën 24 orë pas së parës.
3. Anëtarët e Komisionit marrin pjesë rregullisht në të gjitha mbledhjet e tij, me përjashtim të rasteve kur, për arsye objektive dhe pas njoftimit paraprak të Kryetarit, nuk mund të jenë të pranishëm.
4. Në rast të pamundësisë së zhvillimit të mbledhjeve të KPPPA me pjesëmarrje fizike (në situata të jashtëzakonshme) është i vlefshëm zhvillimi i veprimtarisë *online*. Në këto raste veprimtaria regjistrohet dhe vendimet zbardhen në formë shkresore.
5. Në rast të pamundësisë së pjesëmarrjes fizike në mbledhje, anëtari i KPPPA mund të shprehë mendimin e tij dhe të votojë *online*. Pas votimit *online*, e dërgon mendimin dhe votën e vet me postë elektronike. Ky e-mail duhet të shpërndalet te të gjithë anëtarët e tjerë të KPPPA dhe përfshihet në procesverbalin e mbledhjes.
6. Anëtarët e Komisionit, në kryerjen e detyrave, duhet të jenë të paanshëm dhe të shmangin konfliktin e interesit, në përputhje me përcaktimet në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
7. Gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, anëtarët e Komisionit, janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin.

Neni 11

Marrja e vendimeve

1. Komisioni merr vendime vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes, me përjashtim të rasteve kur të paktën 2/3 e anëtarëve të pranishëm në mbledhje, vendosin për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve, për çështje që nuk janë në rendin e ditës.
2. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
3. Si rregull, votimi është i hapur. Komisioni rast pas rasti, vendos për çështje për të cilat vlerëson se, për marrjen e vendimeve, votimi duhet të jetë i fshehtë.
4. Anëtarët e Komisionit, që janë të pranishëm në mbledhje dhe që nuk kanë ndonjë pengesë ligjore për të votuar, shprehin qëndrimin e tyre "pro"/"kundër". Mendimi "kundër" paraqitet me shkrim dhe i bashkëlidhet vendimit.
5. Kryetari i Komisionit, voton i fundit. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare.
6. Vendimet nënshkruhen nga Kryetari i Komisionit.
7. Vendimet për dhënien e titujve akademikë hartohen në pesë kopje, 1 (një) kopje ruhet në dokumentacionin e Komisionit, 1 (një) kopje i dërgohet Rektorit të UMT-së, i cili e drejton në drejtorinë përkatëse për vijimin e procedurës, 1 (një) kopje i jepet kandidatit, 1 (një) kopje depozitohet pranë Zyrës së Protokoll Arkivës në Rektoratin e UMT-së, 1 (një) kopje përcillet pranë AKKSHI-t.

Neni 12

Procesverbali

1. Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal, i cili përmban informacion për datën e zhvillimit të mbledhjes, për pjesëmarrësit, për çështjet e rendit të ditës, një përmbledhje të diskutimeve, rezultatin e votimit, vendimet si dhe veprimet e mëtejshme në zbatim të vendimeve.
2. Procesverbali mbahet nga Sekretari Teknik i Komisionit dhe duhet t'u paraqitet për miratim dhe nënshkrim të gjithë anëtarëve në fillim të mbledhjes pasardhëse.
3. Çdo anëtar i Komisionit ka të drejtë të kërkojë të shënohet në procesverbal, mendimi i tij për trajtimin e një çështje të caktuar, mendimin "kundër" mbi argumente të veçanta, si edhe të kërkojë përfshirjen e një deklarami të parapërgatitur me shkrim, sipas rendit të ditës, në pamundësi të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në mbledhje.

Neni 13

Sekretari Teknik i Komisionit

1. Komisioni asistohet në veprimtarinë e tij nga një sekretar teknik, i cili propozohet nga Rektori nga radhët e personelit ndihmëskademi të Rektoratit të UMT-së, në mbledhjen e tij të parë pas konstituimit dhe miratohet nga KPPPA-ja me shumicë të thjeshtë të votave (50%+1).
2. Sekretari teknik kryen këto detyra:

- a) administron kërkesat dhe dokumentacionin e dosjeve të aplikantëve për titujt akademikë;
 - b) merr masa për krijimin e kushteve për mbarëvajtjen e mbledhjeve të Komisionit, sipas udhëzimeve të Kryetarit;
 - c) mban dhe nënshkruan procesverbalin e mbledhjeve, i cili vihet në dispozicion të anëtarëve në mbledhjen pasardhëse të Komisionit;
 - d) zbardh vendimet e marra, si rregull, jo me vonë se 5 (pesë) ditë pune nga përfundimi i mbledhjes;
 - e) kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkon Komisioni dhe kryetari i tij, brenda fushës së veprimtarisë.
3. Në rast mungese të tij, për arsye objektive, për një mbledhje të njoftuar, sekretari zëvendësohet nga anëtari më i ri në moshë.

KREU III

STANDEDET PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË

Neni 14

E drejta për promovim për titull akademik

1. Për fitimin e titullit akademik "Profesor i Asociuar" mund të aplikojë personeli akademik i kategorisë "Lektor", i cili ka mbrojtur gradën shkencore "Doktor" të paktën 5 (pesë) vjet para datës së aplikimit për fitimin e titullit të mësipërm.
2. Për fitimin e titullit akademik "Profesor" mund të aplikojë personeli akademik i cili ka titullin akademik "Profesor i Asociuar". Personeli akademik, i cili mban titullin akademik "Profesor i Asociuar" aplikon për fitimin e titullit akademik "Profesor" të paktën 5 (pesë) vjet pas fitimit të titullit akademik "Profesor i Asociuar".
3. Konsiderohet datë e mbrojtjes së gradës shkencore/titullit akademik, data e vendimit final të organit përgjegjës për dhënien e gradës/titullit, bazuar në legjislacionin në fuqi në kohën kur kjo gradë/ky titull është dhënë.
4. Kanë të drejtë të kërkojnë promovim për fitim të një titulli akademik pranë UMT-së:
 - a) anëtarët e personelit akademik me kohë të plotë të UMT-së;
 - b) anëtarët e personelit akademik me kohë të pjesshme të UMT-së;
 - c) anëtarët e personelit akademik të institucioneve të tjera të arsimit të lartë, në rastet kur këto institucione nuk përmbushin kriteret për promovim akademik;
 - d) personat, të cilët nuk janë personel akademik pranë ndonjë institucioni, por përmbushin standardet dhe kriteret për fitimin e titujve akademikë.

Neni 15

Kriteret për fitimin e titullit akademik "Profesor i Asociuar"

Ka të drejtë të aplikojë për fitimin e titullit akademik "Profesor i Asociuar" personeli akademik i kategorisë "lektor", i cili plotëson këto kriteret:

1. Ka kaluar një periudhë të paktën 5 (pesë) vjet, nga data që ka mbrojtur gradën shkencore "Doktor";

2. Ka zhvilluar një cikël të plotë leksionesh për, së paku, një lëndë, për 3 (tre) vite akademike;
3. Ka përvojë pune si personel akademik me kohë të plotë për një periudhë, së paku, 5 (pesë)-vjeçare, me apo pa ndërprerje ose me kohë të pjesshme si lektor, për një periudhë 8 (tetë)-vjeçare akademike, me apo pa ndërprerje. Personeli akademik që ka përvojë akademike me kohë të plotë më të ulët se pesë vite, por ka përvojë pune si personel akademik me kohë të pjesshme më të ulët se 8 (tetë) vite, koha e pjesshme i konvertohet si vite me kohë të plotë, e cila përlllogaritet me një koeficient prej 1.6 vite kohë e pjesshme, e konvertuar në 1 (një) vit përvojë pune me kohë të plotë, pas fitimit të gradës shkencore “Doktor”;
4. Të jetë i aftë të mbajë leksione në një nga pesë gjuhët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian: angleze, frënge, gjermane, italiane, spanjolle si dhe të mbrojë veprimtarinë kërkimore botuese përpara Jurisë së vlerësimit të miratuar nga KPPPA, në një nga gjuhët e mësipërme, në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UMT-së.
5. Ka botuar, së paku, 5 (pesë) artikuj shkencorë në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku, 2 (dy) prej artikujve të jenë botuar në revista ndërkombëtare të indeksuara në Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimi të Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI);
6. Ka realizuar si autor i parë, së paku, 5 (pesë) referime, nga të cilat, së paku, 2 (dy) janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

Neni 16

Ekuivalentimi i veprimtarive për titullin akademik “Profesor i Asociuar”

Në përmbushje të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë, të parashikuara në Vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për fitimin e titullit akademik “Profesor i Asociuar”, ekuivalentimi i veprimtarive të kryera nga kandidatët, bëhet si më poshtë:

1. Botimi i 1 (një) monografie shkencore, e botuar pas fitimit të gradës shkencore “doktor”, brenda ose jashtë vendit, e cila duhet të përmbushë kushtet e origjinalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore, dhe të jetë pranuar nga njësi bazë, që mbulon fushën e kërkimit. Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e rankuar nga *SENSE Ranking of Academic Publishers*, në kategorinë A, B, C ose D. Monografite konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre kur ndryshojnë në përmbajtje me, të paktën, 70%. Monografia e botuar brenda vendit duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) “Profesorë” të fushës kërkimore-shkencore, nga të cilët, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga vendet anëtare të BE-së, OECD-së ose G20-ës si dhe konsiderohet e vlefshme vetëm nëse është e aprovuar nga Këshilli i Botimeve në UMT.
2. Monografia e botuar brenda vendit ekuivalentohet me:
 - i) 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;
 - ii) 1 (një) artikull shkencor që është botuar në revistë ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me

indikatorë citimit të Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI).

3. Monografia e botuar jashtë vendit ekuivalentohet me:
 - i. 4 (katër) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;
 - ii. 2 (dy) artikuj shkencorë që janë botuar në revistë ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimit të Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI).
4. Monografia nuk mund përdoret për të ekuivalentuar më shumë se një kriter të munguar /të paplotësuar nga kandidati për titull akademik.
5. Për efekt të promovimit akademik, institucionet e arsimit të lartë marrin në konsideratë angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit, pas fitimit të gradës shkencore “doktor”, në:
 - a) komitete shkencore të konferencave kombëtare, ndërkombëtare, apo redaktues për materialet e këyre konferencave;
 - b) veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues për llogari të periodikëve ose joperiodikëve shkencorë;
 - c) projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtar;
 - d) përfitimin e financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar;
 - e) projekte të financuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit;
 - f) vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;
 - g) si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;
 - h) projektet e transferimit teknologjik të patentave.
6. Angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit në së paku 4 (katër) veprimtari të përcaktuara në pikën 5, të këtij neni, mund të ekuivalentohet me:
 - a) 1 (një) artikull shkencor që është botuar në revistë ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimit të Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI)
ose
 - b) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit dhe 2 (dy) referime mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “*Proceedings*”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.
7. Pavarësisht numrit të lartë të angazhimit dhe pjesëmarrjes së kandidatit në veprimtari shkencore, nuk mund të bëhet më shumë se 1 (një) ekuivalentim sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6/a/b të këtij neni.
8. Raporti për angazhimin dhe pjesëmarrjen për veprimtaritë e parashikuara në pikën 5 të këtij neni hartohet nga njësia bazë e njësia kryesore dhe miratohet nga Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT.

9. Në rastet kur kandidati ka realizuar studim postdoktoratë në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, me një kohëzgjatje, të paktën, 6 (gjashtë) muaj, shoqëruar me raport të detajuar për aktivitetin kërkimor-shkencor të zhvilluar gjatë kësaj periudhe, ai ekuivalentohet me 1 (një) artikull shkencor të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti dhe 1 (një) referim të mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “*Proceedings*”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.
10. Botimet shkencore të vlefshme janë ato të realizuara pas mbrojtjes së gradës shkencore “doktor”, deri në datën e dorëzimit të dosjes së aplikimit për titullin akademik “Profesor i Asociuar”.

Neni 17

Kriteret për fitimin e titullit akademik “Profesor”

Ka të drejtë të aplikojë për fitimin e titullit akademik “Profesor”, ai që mban titullin akademik “Profesor i Asociuar”, i cili plotëson këto kriteret:

1. Mban titullin akademik “Profesor i Asociuar”, të paktën 5 (pesë) vjet, nga data e fitimit të tij;
2. Ka qenë titullar lënde ose moduli dhe udhëheqës i veprimtarisë shkencore për një periudhë jo më të shkurtër se 5 (pesë) vite akademike;
3. Është ose ka qenë i punësuar si personel akademik me kohë të plotë për një periudhë 8 (tetë)-vjeçare akademike, pas fitimit të gradës shkencore “Doktor”, ose me kohë të pjesshme, për një periudhë 12 (dymbëdhjetë)-vjeçare akademike pas fitimit të gradës shkencore “Doktor”. Personeli akademik që ka përvojë akademike me kohë të plotë më të ulët se 8 (tetë) vite, por ka përvojë pune si personel akademik me kohë të pjesshme më të ulët se 12 (dymbëdhjetë) vite, koha e pjesshme i konvertohet si vite me kohë të plotë, e cila përlllogaritet me një koeficient prej 1.5 vitesh kohë e pjesshme, e konvertuar në 1 (një) vit përvojë pune me kohë të plotë, pas fitimit të gradës shkencore “Doktor”;
4. Si rregull, të ketë udhëhequr ose bashkëudhëhequr, të paktën 2 (dy) doktorata. Bashkëudhëheqja duhet të jetë me personel akademik të kategorisë “Profesor”, me IAL brenda ose jashtë vendit, në bazë të një marrëveshjeje dypalëshe. Në rast se kandidati ushtron veprimtarinë e tij akademike shkencore pranë një njësie kryesore me më pak se 40 (dyzet) veta personel akademik me kohë të plotë, duhet të ketë udhëhequr/bashkëudhëhequr, të paktën, 1 (një) doktoratë të përfunduar, ndërsa kriteri për udhëheqjen e doktoratës tjetër konsiderohet i plotësuar nëse kandidati është angazhuar në mësimdhënie në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-s, të paktën për një periudhë prej 6 (gjashtë) muajsh pa ndërprerje ose 1 (një) vit me ndërprerje, në tri vitet e fundit;
5. Të jetë i aftë të mbajë leksione në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Evropian: angleze, frënge, gjermane, italiane, spanjolle si dhe të mbrojë veprimtarinë kërkimore-shkencore përpara Jurisë së vlerësimit të miratuar nga KPPPA, në një nga këto gjuhë, në përputhje me statutin dhe rregulloren e IAL-së;
6. Të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizimin e detyrimeve, si më poshtë vijon:
 - i. Ka botuar, së paku, 7 (shtatë) artikuj shkencorë në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku, 3 (tre) prej artikujve të jenë botuar në revista ndërkombëtare të indeksuara në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të

- njohura ndërkombëtarisht, si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimit të Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI);
- ii. Ka realizuar si autor i parë, së paku, 5 (pesë) referime, nga të cilat, së paku 2 (dy) janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

Neni 18

Ekuivalentimi i veprimtarive për titullin akademik "Profesor"

Në përmbushje të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë, të parashikuara në Vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për fitimin e titullit akademik "Profesor", ekuivalentimi i veprimtarive të kryera nga kandidatët, bëhet si më poshtë:

1. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në nenin 17, pika 6, shkronja "i", të kësaj Rregullore, sipas ekuivalentimit që vijon:
 - a) Botimi i 1 (një) monografie shkencore, e botuar pas fitimit të gradës shkencore "Profesor i Asociuar" brenda ose jashtë vendit, e cila duhet të përmbushë kushtet e origjinalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore, dhe të jetë pranuar nga njësi bazë, që mbulon fushën e kërkimit. Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e rankuar nga SENSE Ranking of Academic Publishers, në kategorinë A, B, C ose D. Monografitë konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre kur ndryshojnë në përmbajtje me, të paktën, 70%. Monografia e botuar brenda vendit duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) "Profesorë" të fushës kërkimore-shkencore, nga të cilët, të paktën njëri prej tyre duhet të jetë nga vendet e BE-së, OECD-së ose G20-ës si dhe konsiderohet e vlefshme vetëm nëse është e aprovuar nga Këshilli i Botimeve në UMT;
 - b) Monografia e botuar brenda vendit ekuivalentohet me:
 - i. 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;
 - ii. 1 (një) artikull shkencor që është botuar në revistë ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimit të Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI).
 - c) Monografia e botuar jashtë vendit ekuivalentohet me:
 - i. 4 (katër) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;
 - ii. 2 (dy) artikuj shkencorë që janë botuar në revistë ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimit të Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI).
2. Monografia nuk mund përdoret për të ekuivalentuar më shumë se një kriter të munguar /të paplotësuar nga kandidati për titull akademik.

3. Për efekt të promovimit akademik, institucionet e arsimit të lartë marrin në konsideratë angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit, pas fitimit të titullit akademik “Profesor i Asociuar”, në:
 - a) komitete shkencore të konferencave kombëtare, ndërkombëtare, apo redaktues për materialet e këyre konferencave;
 - b) veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues, për llogari të periodikëve ose joperiodikëve shkencorë;
 - c) projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtar;
 - d) përfitimin e financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar;
 - e) projekte të financuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit;
 - f) vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;
 - g) si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;
 - h) projektet e transferimit teknologjik të patentave.
4. Angazhimi dhe pjesëmarrja e kandidatit në së paku 4 (katër) veprimtari të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, mund të ekuivalentohet me:
 - a) 1 (një) artikull shkencor që është botuar në revistë ndërkombëtare, e indeksuar në një nga databazat e të dhënave të revistave shkencore të njohura ndërkombëtarisht, si Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimit të Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI)”
ose
 - b) 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore brenda vendit, dhe 2 (dy) referime të mbajtura në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “*Proceedings*”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.
5. Pavarësisht numrit të lartë të angazhimit dhe pjesëmarrjes së kandidatit në veprimtari shkencore, nuk mund të bëhet më shumë se 1 (një) ekuivalentim sipas përcaktimeve të bëra në pikën 4/a/b të këtij neni.
6. Raporti për angazhimin dhe pjesëmarrjen për veprimtaritë e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, hartohet nga njësia bazë e njësisë kryesore dhe miratohet nga Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT.
7. Për fitimin e titullit akademik “Profesor”, botimet shkencore të vlefshme janë ato të realizuara pas mbrojtjes së titullit akademik “Profesor i Asociuar” deri në datën e dorëzimit të dosjes së aplikimit për titullin akademik “Profesor”.

KREU IV PROCEDURAT PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË

Neni 19 Procedura e aplikimit

1. Kandidati personel akademik me kohë të plotë në UMT, që kërkon të promovohet për titull akademik, paraqet kërkesën dhe dosjen pranë drejtuesit të njësisë kryesore, i cili ja përcjell për vlerësim njësisë bazë, brenda 20 (njëzet) ditëve nga paraqitja e kërkesës.

2. Kur kandidatët i përkasin kategorive të përcaktuara në shkronjat “b”, “c” dhe “d” të pikës 4 të nenit 14 të kësaj Rregulloreje, kërkesa i drejtohet KPPPA dhe dosja depozitohet në Zyrën e Protokoll Arkivës në Rektoratin e UMT-së. Komisioni vendos se, cila është njësia kryesore më e përshtatshme për promovimin e kandidatit dhe ia përcjell dosjen kësaj të fundit për fillimin e procedurës. Njësia kryesore përcakton njësinë bazë më të përshtatshme për vlerësimin e kandidatit dhe ia përcjell dosjen kësaj njësie bazë për vlerësim sipas pikës 1 të këtij neni.
3. Dosja e kandidatit depozitohet e inventarizuar, 1 (një) kopje e inventarit qëndron në dosje, ndërsa kopja tjetër i jepet kandidatit.
4. Dosja e aplikimit duhet të përmbajë këto dokumente:
 - a) Kërkesë;
 - b) CV në formatin *Europass*;
 - c) Fotokopje e letërnjoftimit ose pasaportës;
 - d) Vërtetim i punësimit aktual, lëshuar nga titullari i institucionit;
 - e) Vërtetim për mësimdhënien sipas afateve kohore të parashikuara në Vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave;
 - f) Vërtetim nga institucioni për statusin e titullarit të lëndës;
 - g) Vërtetim për udhëheqjen e doktoratave në rastin e aplikimit për titullin akademik “Profesor”;
 - h) Kopje e noterizuar e diplomës së gradës shkencore “Doktor” në rastin e aplikimit për titullin akademik “Profesor i Asociuar”;
 - i) Kopje e noterizuar e diplomës së gradës shkencore “Doktor” dhe titullit akademik “Profesor i Asociuar” në rastin e aplikimit për titullin akademik “Profesor”;
 - j) Listë e referimeve në konferenca shkencore e shoqëruar me programin, dëshminë e referimit në konferencë dhe botimin në *proceedings* (sipas nenit 17, pika 5 të kësaj Rregulloreje), me ISBN/ISSN, e shoqëruar me dokumentet origjinale ose fotokopje dhe link-u i aksesueshëm, e nënshkruar në çdo fletë nga kandidati;
 - k) Listë e botimeve të artikujve shkencorë e shoqëruar me botimet origjinale ose fotokopje dhe link-u i aksesueshëm, si dhe dëshminë e rankimit të revistës, sipas përcaktimeve në Vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave;
 - l) Listë e monografive e shoqëruar me botimet origjinale ose fotokopje dhe link-u i aksesueshëm, si dhe dëshminë e rankimit të shtëpisë botuese sipas përcaktimeve në Vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, sipas formularit të hartuar nga Komisioni;
 - m) Listë e pjesëmarrjes në komitete shkencore, botuese, projekte kërkimore, vlerësime të projekteve, projekte të transferimit teknologjik të patentave, e shoqëruar me dokumente që vërtetojnë pjesëmarrjen dhe kontributin, lëshuar nga drejtuesi i komiteteve, revistave, projekteve, e nënshkruar në çdo fletë nga kandidati;
 - n) Dëshmi për studime postdoktorale në një shtet tjetër, sipas përcaktimeve në Vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, e shoqëruar me raportin e detajuar për aktivitetin kërkimor-shkencor të zhvilluar gjatë periudhës përkatëse, e konfirmuar nga drejtuesi i studimeve postdoktorale;
 - o) Në rastin kur kandidati për titullin “Profesor”, ka bashkëudhëhequr doktoratë, kopje e marrëveshjes së bashkëpunimit të institucionit me IAL e huaj ose vendase;

- p) Kopje elektronike e të gjithë dokumentacionit të kandidatit e regjistruar në 2 (dy) CD; një CD arkivohet në njësinë kryesore, kopja tjetër është pjesë dhe ruhet në dosjen e kandidatit;
- q) Formular vetëdeklarimi, sipas të cilit, kandidati mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e dokumentacionit që përmban dosja.

Neni 20

Të drejtat dhe detyrimet e kandidatit për fitimin e titullit akademik

1. Të drejtat e kandidatit:
 - a) të paraqesë kërkesën dhe dosjen për fitimin e titullit në përputhje me aktet ligjore, nënligjore në fuqi dhe kësaj rregulloreje;
 - b) të kërkojë informacion për ecurinë e procedurës së aplikimit dhe vlerësimit;
 - c) të kërkojë informacion për vendimet e marra në të gjitha nivelet lidhur me aplikimin që ka paraqitur;
 - d) të paraqesë ankesë lidhur me procedurat dhe vendimet e marra për fitimin e titullit;
 - e) të përsërisë kërkesën brenda afatit kohor të parashikuar në Vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, përkatësisht brenda 6 (gjashtë) muajve nga refuzimi nga njësia bazë, ose pas një periudhe jo më të shkurtër se 2 (dy) vjet nga refuzimi i Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik.
2. Detyrimet e kandidatit:
 - a) të përgatisë dokumentacionin e aplikimit sipas kërkesave të akteve ligjore, nënligjore në fuqi dhe kësaj rregulloreje;
 - b) të respektojë procedurat për fitimin e titullit;
 - c) të respektojë afatet e procedurave;
 - d) të plotësojë dokumentacionin shtesë në rastin kur kërkohet;
 - e) të paguajnë tarifën për shërbimin e kryer, sipas vendimit të Bordit të Administrimit.

Neni 21

Detyrat e njësisë bazë, drejtuesit të njësisë kryesore dhe Senatit Akademik

- I. Detyrat e njësisë bazë
 1. Njësia bazë, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve kalendarike nga marrja në dorëzim e dosjes së kandidatit nga drejtuesi i njësisë kryesore, vlerëson dosjen për titullin akademik "Profesor" ose "Profesor i Asociuar".
 2. Pas vlerësimit të dosjes, njësia bazë merr vendim miratues ose refuzues me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të saj. Nëse dosja përmbush standardet shtetërore të titujve akademikë të përcaktuara në Vendimin përkatës të KM-së, si dhe bazuar këtë Rregullore, njësia bazë përgatit relacionin për aktivitetin pedagogjik, kërkimor-shkencor të kandidatit, raportin për angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit në veprimtaritë e parashikuara në nenin 16 dhe 18, kur nevojitet një i tillë, dhe së bashku me skedën (formatin) përmbledhëse të miratuar nga KPPPA i përcjell drejtuesit të njësisë kryesore, me shkresë përcjellëse, dosjen e kandidatit bashkë me 2 (dy) kopjet elektronike në CD që përmban të gjithë dokumentacionin e dosjes.

3. Nëse njësia bazë, me shumicë votash nga anëtarët e saj jep vlerësim negativ, dosja i kthehet drejtuesit të njësisë kryesore me argumentet dhe sugjerimet përkatëse. Drejtuesi i njësisë kryesore njofton me shkresë kandidatin për vendimin e njësisë bazë, duke vënë gjithashtu në dijeni Rektorin dhe KPPPA. Kandidati ka të drejtë të aplikojë sërish, brenda një afati kohor prej 6 (gjashtë) muajsh pas plotësimit të dosjes sipas kriterëve të përcaktuara në VKM.
4. Në rast të pamundësisë së zhvillimit të mbledhjeve të njësisë bazë me pjesëmarrje fizike, është i vlefshëm zhvillimi i veprimtarisë *online*. Në këto raste veprimtaria regjistrohet dhe vendimet zbardhen në formë shkresore.
5. Në rast të pamundësisë së pjesëmarrjes fizike në mbledhje, anëtari i njësisë bazë mund të shprehë mendimin e tij dhe të votojë *online*. Pas votimit *online*, e dërgon mendimin dhe votën e vet me postë elektronike. Ky e-mail duhet të shpërndalet te të gjithë anëtarët e tjerë të njësisë bazë dhe përfshihet në procesverbalin e mbledhjes.

II. Detyrat e drejtuesit të njësisë kryesore

1. Drejtuesi i njësisë kryesore pranon aplikimet për titujt akademikë nga kandidatë, sipas përcaktimeve në nenin 19, pika 1 të kësaj Rregulloreje dhe brenda 20 (njëzet) ditëve nga marrja e dosjes, ia përcjell njësisë bazë përkatëse për vlerësim.
2. Drejtuesi i njësisë kryesore, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja në dorëzim e dosjes, i përcjell me shkresë përcjellëse Senatit Akademik, dosjen e aplikimit të kandidatit, vendimin e njësisë bazë bashkë me relacionin, sipas formatit të skedës së miratuar nga KPPPA, propozimin për anëtarët e jurisë, në rastet kur kërkohet ekuivalentim edhe raportin për angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit për veprimtaritë e parashikuara në pikën 7 të kreut II dhe pikën 6 të kreut III të VKM, nr. 112/2018, i ndryshuar, 2 (dy) CD me dokumentacionin e plotë të aplikimit të kandidatit.
3. Në rastin kur njësia bazë ka dhënë vlerësim negativ, drejtuesi i njësisë kryesore i kthen kandidatit dosjen me materialet e printuara, vendimin përkatës për vlerësimin negativ, ndërsa njëra nga CD-të arkivohet, duke vënë gjithashtu në dijeni Rektorin dhe KPPPA për vendimin e njësisë bazë.

III. Detyrat e Senatit Akademik

1. Pas vlerësimit nga njësia bazë, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, dosja e kandidatit përmes drejtuesit të njësisë kryesore përkatëse i përcillet Senatit Akademik.
2. Senati Akademik përmes kryetarit të tij, brenda 20 (njëzet) ditëve nga marrja e dosjes, ia përcjell atë KPPPA-së.

Neni 22

Procedura e vlerësimit të dosjes së kandidatit

1. Komisioni për dhënien e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, vlerëson dosjen e çdo kandidati që i paraqet, Senati Akademik, njësia kryesore pranë së cilës ai ka aplikuar për marrjen e titullit akademik “Profesor i Asociuar” ose “Profesor”.
2. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas përcjelljes së dosjes nga Senati Akademik, Komisioni vlerëson nëse dosja e dorëzuar nga kandidati është e plotë apo jo, përta i përket përmbajtjes së dokumenteve, duke caktuar për këtë qëllim 2 (dy) relatorë, nga përbërja e KPPPA-së.

Relatorët, kur është e mundur, janë përfaqësues të së njëjtës fushë ose të fushës më të afërt me profilin që kandidati kërkon të marrë titullin përkatës.

3. Relatorët e caktuar nga Komisioni, në rast të evidentimit të mangësive të dokumenteve në dosjen e kandidatit, këtij të fundit i jepen 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kohë për të bërë plotësimet e nevojshme. Në rast se ato nuk plotësohen, dosja i kthehet kandidatit.
4. Në rast se dosja konsiderohet e plotë, Komisioni vijon menjëherë, në të njëjtën mbledhje, me ngritjen e jurisë për vlerësimin e dosjes.
5. Data e nisjes së procedurës së vlerësimit të kandidatit konsiderohet data e ngritjes së jurisë. Brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e nisjes së procedurës së vlerësimit, juria përgatit raportin e vlerësimit të kapaciteteve akademiko-didaktike e shkencore të kandidatit, në përfundim të të cilit jepet edhe rekomandimi për dhënien ose jo të titullit akademik. Raporti i vlerësimit i përcillet Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT.

Neni 23

Ngritja dhe funksionimi i jurisë për vlerësimin e kandidatit

1. Juria përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, me titullin akademik “Profesor”, të së njëjtës fushë ose fushave të ngjashme me atë të kandidatit, prej të cilëve, të paktën, 2 (dy) duhet të jenë të ftuar nga institucione të tjera të arsimit të lartë, vendase ose të huaja, ose personalitete të spikatura, të së njëjtës fushë me atë të kandidatit, jashtë UMT-së.
2. Anëtarët e jurisë propozohen nga njësia bazë dhe miratohen nga drejtuesi i njësisë kryesore, i cili e përcjell për në Senatin Akademik.
3. Numri i anëtarëve të propozuar është jo më pak se 8 (tetë), nga të cilët 5 (pesë) të jenë të brendshëm dhe 3 (tre) të jashtëm.
4. Juria i përcjell KPPPA në formë shkresore raportin e vlerësimit.
5. Në rastin kur anëtari i jurisë nuk ka të njëjtin vlerësim me pjesën tjetër të saj, ai harton një raport të veçantë, i cili i bashkëngjitet raportit të pjesës tjetër të jurisë.
6. Raporti miratohet me shumicën e anëtarëve të jurisë.
7. Anëtarët e jurisë mbajnë përgjegjësi ligjore dhe etike, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, për vërtetësinë e të dhënave të përfshira në raportin e tyre të vlerësimit.
8. Në rast të pamundësisë së zhvillimit të mbledhjeve të jurisë me pjesëmarrje fizike, është i vlefshëm zhvillimi i veprimtarisë *online* (në situata të jashtëzakonshme). Në këto raste veprimtaria regjistrohet dhe vendimet zbardhen në formë shkresore.
9. Në rast të pamundësisë së pjesëmarrjes fizike në mbledhje, anëtari i jurisë mund të shprehë mendimin e tij dhe të votojë *online*. Pas votimit *online*, e dërgon mendimin dhe votën e vet me postë elektronike. Ky e-mail duhet të shpërndahet te të gjithë anëtarët e tjerë të jurisë dhe përfshihet në procesverbalin e mbledhjes.
10. Raporti i vlerësimit të jurisë dhe rekomandimi nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e jurisë.

Neni 24

Vlerësimi i kandidatit nga KPPPA

1. Komisioni merr vendim përfundimtar për miratimin ose refuzimin e kërkesës së kandidatit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas marrjes së raportit të vlerësimit nga juria.

2. Në rastin e votimit të raportit të vlerësimit të jurisë dhe marrjes së vendimit përfundimtar, në mbledhje duhet të marrin pjesë, jo më pak se 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë të Komisionit dhe votimi është miratues kur votojnë “pro”, jo më pak se 8 (tetë) anëtarë të tij. Kur në mbledhje marrin pjesë të gjithë anëtarët e Komisionit, votimi është miratues kur votojnë “pro”, jo më pak se 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë të tij.
3. Në rast refuzimi të kërkesës për fitimin e titujve akademikë nga Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, kandidatit i lind e drejta të ripërsërisë kërkesën, pas një periudhe kohore jo më të shkurtër se 2 (dy) vite nga data e paraqitjes së kërkesës së mëparshme.

Neni 25

Konflikti i interesit dhe çështjet e etikës

1. Konflikti i interesit lind nga një rrethanë, në të cilën vlerësuesi mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij. Papajtueshmëria me detyrën e caktuar lind kur:
 - a) anëtari i propozuar i jurisë ka lidhje familjare me kandidatin;
 - b) relatori/anëtari i jurisë, ka një interes personal të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë me vendimmarrjen në shqyrtim;
 - c) në raste të tjera, sipas përcaktimeve në Kodin e Procedurave Administrative,
2. Në momentin kur anëtari i propozuar për pjesëmarrje si relator ose në juri, konstaton papajtueshmëri me detyrën e caktuar, ka detyrimin të kërkojë tërheqjen e kandidaturës së tij.
3. Në rastin kur anëtari i jurisë heq dorë nga anëtarësia në juri, atëherë Komisioni e zëvendëson atë me njërin prej anëtarëve të tjerë nga 8 (tetë) propozimet e paraqitura nga drejtuesi i njësisë bazë.

Neni 26

Ankimi për vendimin e vlerësimit

1. Çdo kandidat gëzon të drejtën e ankimit ndaj vendimeve dhe procedurave të ndërmjetme të ndjekura prej njësisë bazë, njësisë kryesore dhe KPPPA, deri para marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionit.
2. Kandidati mund të paraqesë ankim nëse vendimi është nxjerrë:
 - a) si rezultat i shkeljes së dispozitave lidhur me procedurën e marrjes së vendimeve nga njësia kryesore, njësia bazë ose Komisioni;
 - b) si rezultat i zbatimit të gabuar të akteve ligjore dhe nënligjore;
 - c) vendimi nuk është i bazuar në fakte dhe provat e paraqitura.
3. Ankimi paraqitet brenda brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike, nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi për njësinë bazë/kryesore i drejtohet KPPPA-së. Komisioni ngrë një komision *ad hoc* të përbërë prej 3 (tre) anëtarësh, i cili shqyrton ankesën, bën verifikimin dhe përgatit relacionin që ia paraqet Komisionit.
5. Komisioni e shqyrton ankimin dhe merr vendim, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga paraqitja e tij.

6. Vendimet e Komisionit për shqyrtimin e ankimit janë përfundimtare dhe i njoftohen zyrtarisht ankimuesit nga Kryetari.

Neni 27

Shfuqizimi i titujve akademikë

1. Titulli akademik mund të shfuqizohet në rastet kur vërtetohet se, në veprimtarinë shkencore të kandidatit (artikull shkencor, referim në konferenca, monografi të botuar, etj.), e cila ka shërbyer për promovimin e tij për titull akademik, konstatohen sjellje dhe praktika të papranueshme, në kundërshtim me parimet e etikës dhe integritetit në kërkimin shkencor, konkretisht:
 - i. Fabrikim - sajim i rezultateve dhe regjistrimi i tyre sikur të ishin të vërteta;
 - ii. Falsifikim - manipulim i materialeve të kërkimit, pajisjeve apo proceseve ose ndryshimi, heqja apo shmangia e të dhënave apo rezultateve pa justifikim;
 - iii. Plagjiaturë - përdorim i ideve dhe punës së të tjerëve pa ia njohur vlerën burimit origjinal, duke shkelur në këtë mënyrë të drejtat e autorëve dhe produktet e tyre intelektuale.
2. Titulli akademik mund të shfuqizohet edhe kur vërtetohet se, kandidati ka paraqitur të dhëna të pavërteta, ose i ka falsifikuar ato, me qëllim përmbushjen e standardeve të përcaktuara nga vendimi përkatës i Këshillit të Ministrave, për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe/ose “Profesor”.
3. Vendimi për shfuqizimin, merret vetëm pasi të jenë ndjekur procedurat administrative, sipas përcaktimeve në Kodin e Procedurave Administrative.
4. Barra e provës për të provuar akuzat mbi plagjiaturën, manipulimin e të dhënave në punimet e kandidatit, apo paraqitjen e të dhënave të pavërteta, ose të falsifikuara bie mbi subjektin që ka ngritur akuzën.
5. Vendimi merret me 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve të KPPPA të UMT, pas rekomandimit të dhënë nga komisioni *ad hoc*, i caktuar nga Senati Akademik, i përbërë nga të paktën 3 (tre) anëtarë të Senatit Akademik, të cilët mbajnë titullin akademik “Profesor”, të së njëjtës fushë ose fushave të përafërta.
6. Përpara marrjes së vendimit, komisioni *ad hoc* njofton personin ndaj të cilit ka filluar procedimi:
 - a) për akuzat e ngritura sipas pikës 1 dhe/ose 2 të këtij neni;
 - b) për të drejtën që ai ka për të paraqitur, me shkrim, sqarimet e tij rreth akuzës së ngritur, si dhe një afat të arsyeshëm, deri kur duhet të paraqitet ky sqarim;
 - c) për të drejtën që ka për të inspektuar dosjen e procedimit, për t’u dëgjuar, ai vetë apo me përfaqësues ligjor, për të paraqitur dëshmitarë, për të paraqitur prova ose për të kërkuar marrjen e tyre;
7. Pasi komisionit *ad hoc* t’i jetë vënë në dispozicion informacioni i kërkuar sipas shkronjës b) të pikës 6 të këtij neni, ky i fundit njofton personin ndaj të cilit ka filluar procedimi, për datën kur do të shqyrtohet akuzat e pretenduar, e cila nuk mund të caktohet më shpejt se 5 (pesë) ditë pune dhe jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune, nga marrja e njoftimit.
8. Procesi i verifikimit kryhet në mënyrë të paanshme, gjithëpërfshirëse, pa cenuar saktësinë dhe objektivitetin e procedimit.

9. Palët e përfshira në procedimin administrativ, deklarojnë çdo konflikt interesi që mund të dalë gjatë verifikimit. Procedurat kryhen në mënyrë konfidenciale, me qëllim mbrojtjen e personave, që janë të përfshirë në verifikim.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 28 Efektet financiare

1. Anëtarët e Komisionit të Përhershëm të Promovimit të Personelit Akademik dhe sekretari teknik paguhen për punën e kryer për dhënien e titujve akademikë, sipas Vendimit përkatës të Bordit të Administrimit.
2. Kandidatët që kërkojnë të promovohen për fitimin e një titulli akademik i nënshtrohen tarifës për shërbimin e kryer, sipas Vendimit përkatës të Bordit të Administrimit, me përjashtim të personelit akademik me kohë të plotë në UMT.

Neni 29 Kontrolli i veprimtarisë

Veprimtaria administrative e KPPPA-së i nënshtrohet kontrollit administrativ, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative mbi mjetet ligjore administrative dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 30 Miratimi, hyrja në fuqi dhe ndryshimi i rregullore

1. Kjo rregullore miratohet me vendim të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe hyn në fuqi menjëherë pas miratimit.
2. Kjo Rregullore i shtrin efektet për kërkesat që do të paraqiten për promovim, pas hyrjes në fuqi të saj.
3. Të drejtën e ndryshimeve në këtë rregullore e ka Senati Akademik i UMT.
4. Propozimet për ndryshime mund të vijnë nga anëtarët e Senatit Akademik të UMT-së, Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, nga Rektori, njësitë kryesore dhe njësitë bazë, të UMT.
5. Me hyrjen në fuqi të saj, shfuqizohet Rregullorja “Për fitimin e titujve akademikë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, e ndryshuar, miratuar me Vendimin nr. 33, datë 17.03.2020 të Senatit Akademik të UMT-së dhe Rregullorja “Mbi organizimin dhe funksionimin e KPPPA të UMT-së”, miratuar me Vendimin nr. 35, datë 17.03.2020 të Senatit Akademik të UMT-së.

KRYETARI
Prof. Dr. Arben GJATA



SHTOJCA NR. 1

Tiranë, më ___/___/___

FORMULAR APLIKIMI PËR TITULLIN “PROFESOR I ASOCIUAR”/ “PROFESOR”

Unë i/e nënshkruari/a paraqes kërkesën dhe dosjen për titullin “Profesor i Asociuar”/ “Profesor”.

Në mbështetje të aplikimit tim, lutem gjeni bashkëlidhur dokumentet si më poshtë listuar:

1. Kërkesë;
2. CV në formatin *Europass*;
3. Fotokopje e letërnjoftimit;
4. Vërtetim i punësimit aktual;
5. Vërtetim për mësimdhënien sipas afateve kohore të parashikuara në Vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave;
6. Vërtetim nga institucioni për statusin e titullarit të lëndës;
7. Vërtetim për udhëheqjen e doktoratave në rastin e aplikimit për titullin akademik “Profesor”;
8. Kopje e noterizuar e diplomës së gradës shkencore “Doktor” (në rastin e aplikimit për titullin akademik “Profesor i Asociuar”) dhe kopje e noterizuar e titullit akademik “Profesor i Asociuar” (në rastin e aplikimit për titullin akademik “Profesor”);
9. Listë e referimeve në konferenca shkencore e shoqëruar me programin, dëshminë e referimit në konferencë dhe botimin në *proceedings*, me ISBN/ISSN, e shoqëruar me dokumentet origjinale ose fotokopje dhe link-u i aksesueshëm, e nënshkruar në çdo fletë nga kandidati;
10. Listë e botimeve të artikujve shkencorë e shoqëruar me botimet origjinale ose fotokopje dhe link-u i aksesueshëm, si dhe dëshminë e rankimit të revistës, sipas përcaktimeve në Vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave;
11. Listë e monografive (nëse ka) e shoqëruar me botimet origjinale ose fotokopje dhe link-u i aksesueshëm, si dhe dëshminë e rankimit të shtëpisë botuese sipas përcaktimeve në Vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, sipas formularit të hartuar nga Komisioni;
12. Listë e pjesëmarrjes në komitete shkencore, botuese, projekte kërkimore, vlerësime të projekteve, projekte të transferimit teknologjik të patentave, e shoqëruar me dokumente që vërtetojnë pjesëmarrjen dhe kontributin, lëshuar nga drejtuesi i komiteteve, revistave, projekteve, e nënshkruar në çdo fletë nga kandidati.
13. Dëshmi për studime postdoktorale në një shtet tjetër (nëse ka), sipas përcaktimeve në Vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, e shoqëruar me raportin e detajuar për aktivitetin kërkimor-shkencor të zhvilluar gjatë periudhës përkatëse, e konfirmuar nga drejtuesi i studimeve postdoktorale;
14. Në rastin kur kandidati për titullin “Profesor”, ka bashkëudhëhequr doktoratë, kopje e marrëveshjes së bashkëpunimit të institucionit me IAL e huaj ose vendase.
15. Kopje elektronike e të gjithë dokumentacionit të kandidatit e regjistruar në 2 (dy) CD;

16. Formular vetëdeklarimi, sipas të cilit, kandidati mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e dokumentacionit që përmban dosja.

Përsa më sipër, deklaroj me përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e dokumentacionit që përmban dosja, origjinale ose fotokopje të noterizuara.

(Emri, Mbiemri)

(Nënshkrimi)

Email:

Cel:

A handwritten signature in blue ink, consisting of several vertical strokes and a horizontal line, located in the bottom right corner of the page.